

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	FAKULTETI I EDUKIMIT
Titulli i lëndës:	<i>Metodologjia e shkencave natyrore</i>
Niveli:	Bachelor – Parashkollor
Statusi lëndës:	Obliguar
Viti i studimeve:	Viti III, semestri i VI
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Fakulteti i edukimit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Zeqir Shaqiri
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:zekiinst@yahoo.com">zekiinst@yahoo.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p><b>Emërtimi i lëndës:</b> <i>Metodologjia e shkencave natyrore</i></p> <p><b>Përmbajtja:</b> Ky kurs ofron qasje të integruar ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme, në të cilën kombinohen procesi i edukimit, i arsimit, lojës së fëmijëve në katër komponentë: shkenca fizike, shkenca e jetës, Toka dhe hapësira si dhe strategjitë e të mësuarit. Kursi përmban një shumëllojshmëri të temave dhe nën temave që trajtojnë çështje nga: <i>Astronomia, Fizika, Kima dhe Biologjia</i>, që synon përgatitjen e studentëve t'i interpretojnë këto njohuri për nivelin e parashkollorëve. Këto aktivitete zhvillohen përmes kureshtjes së fëmijëve në njohjen e vetës dhe botës, për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore, duke i vëzhguar ato në natyrë si dhe duke i paraqitur figurativisht, manipulojnë me mjete e materiale të ndryshme duke i zbuluar mundësitë e transformimit dhe të përdorimit të tyre, ku përmes lojërave të llojllojshme me: ujë, rërë, baltë, borë etj., njeh dhe i kupton cilësitë e tyre (ngjyrën, gjendjen agregate, erën, peshën, vëllimin etj.). Në aktivitete ndërvepruese, me mjedisin jetësor vëzhgojnë dukuritë natyrore: shiun, erën, qiellin, ylberin, ku përmes shëtitjeve në natyrë (në të gjitha stinët e vitit) njihet me ndryshimet atmosferike e veçori të tjera.</p> <p>Në të gjitha këto përfshihet edhe puna laboratorike.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Programi synon të përgatisë studentët edukatorë me një formim praktik të mirë dhe të besueshëm për punë, të

	aftë për të përballuar kërkesat që shtrohen në kurikulën arsimit parashkollor. Programi ofron njohuri teorike për shkencat natyrore si dhe formimin e shprehive të veçanta praktike. Ky kurs ka për qëllim që të përgatisë studentët, në zbatimin dhe planifikimin e punës mësimore me metoda bashkëkohore të mësimdhënies, në shkencat e natyrës.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës:</b> Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ sigurojnë materiale të ndryshme për shkencën nga revista e libra, interneti me qëllim të krijimit të një mjedisi stimulues për të nxitur të menduarit shkencor të fëmijët;</li> <li>➤ zotërojnë konceptet kryesore që lidhen me rregullat, ligjet dhe parimet themelore të lëvizjeve të trupave qiellorë;</li> <li>➤ zotërojnë aftësitë për të përzgjedhur modele, metoda dhe instrumente të thjeshta për demonstrim në laborator, për të vëzhguar objekte të ndryshme;</li> <li>➤ identifikojnë aspektet e planifikimit të suksesshëm të mëimit në shkencat e natyrës;</li> <li>➤ zbatojnë atë që parashihet në planifikimin e punës mësimore me strategji e mësimdhënies bashkëkohore;</li> <li>➤ ndërtojnë qëndrime, vlera dhe vizione koherent, për mësimdhënien dhe të nxënit e shkencave të natyrës në arsimin parashkollor.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë / Javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Kollokfiume, seminare	2	6	12
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në	2	7	14

shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim	1	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	4	4
Projektet, prezantimet , etj	1	13	13
<b>Totali</b>			175 orë
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<b>Format/ Metodot e mësimdhënies:</b> Ligjërata interaktive, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike / projekte, ushtrime laboratorike, ushtrime numerike etj.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shaqiri, Z. (2014). Astronomi dhe astrofizikë, Prishtinë.</li> <li>2. Shaqiri, Z. (2014). Bazat e shkencave natyrore. Prishtinë.</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mato, Dr. Erleta, Kamani, Dr. Pranvera. Sina, Msc. Edlira.( 2010). Një botë për t'u zbuluar. Udhëzues praktik për mësuesit e arsimit parashkollor që punojnë me fëmijët e moshës 4-5 vjeçare. Instituti për Zhvillimin e Arsimit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës &amp; Save the Children.</li> <li>• Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë Udhëzues për drejtorët e institucioneve parashkollore. Mosha parashkollore 0-5 vjeç. Prishtinë, 2012..</li> <li>• Hyseni. H, Shatri. B.(2002). Dituri natyre kl 3, Libri shkollor, Prishtinë.</li> <li>• Hyseni. H, Shatri. B (2003). Dituri natyre kl 4 , Libri shkollor, Prishtinë.</li> </ul>		
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>		
Java e parë:	Njohja me syllabus Lënda dhe metodat e studimit në shkencat natyrore. Njohuritë e njerëzve në kohët e vjetra për dukuritë e ndryshme		

	qiellore.
Java e dytë:	Planetët e sistemit diellor. Natyra fizike e trupave të Sistemit Diellor.
Java e tretë:	Trupat e vegjël të Sistemit Diellor, Toka, Tërmetet
Java e katërt:	Hëna dhe eksplorimi i saj. Spektrat dhe temperatura e yjeve.
Java e pestë:	Madhësitë fizike dhe matja e tyre. Lëvizjet mekanike, Parimet e dinamikës. Puna dhe energjia
Java e gjashtë:	Hidrostatika, Termodinamika
Java e shtatë:	Zëri. Anatomia e veshit. Elektriciteti. Magnetizmi. Rryma elektrike.
Vlerësimi i parë intermediar:	Testi i parë
Java e tetë:	Optika ( drita, thjerra, pasqyra, teleskopi, mikroskopi, syri).
Java e nëntë:	Uji, Ajri, Rrymimet ajrore. Ngrohja dhe ndotja globale.
Java e dhjetë:	Metalet dhe jometalet. Alkoolet. Droga (alkaloidët). Tretësirat. Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera
Java e njëmbëdhjetë:	Qeliza. Ndërtimi i bimëve. Shtazët. Sistemet e organeve
Java e dymbëdhjetë:	Sistemi ( i frymarrjes, muskolor, skeletor, eskretues, i riprodhimit, imun, qarkullimit të gjakut, endokrin).
Java e trembëdhjetë:	Biosfera. Metabolizmi. Ndotja biologjike
Java e katërmëdhjetë:	Rrezatimi radioaktiv. Doza e rrezatimit dhe rreziku
Vlerësimi i dytë intermediar:	Testi i dytë
Java e pesëmbëdhjetë:	Gjenet dhe sëmundjet gjenetike. Acidet nukleike (ADN, ARN).

### Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja	5%
Puna në orët e ushtrimeve (Projekti)	15 %
Testi 1	20 %
Testi 2	20 %
Provimi përfundimtar	40 %
<b>Totali</b>	<b>100 %</b>

Nota përfundimtare:

Pikët (%)	Nota
92-100	10
81-91	9
70-80	8
60-69	7
50-59	6

**Përcaktimi i rregullave:**

- Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje, dhe të marrim pjesë në çdo aktivitet.
- Gjatë orëve mësimore nuk lejohen telefonat celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
- Studenti merr nënshkrim nga lënda, Bazat e shkencave natyrore me metodologji, kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara për semestër.

**Materiale nga web-site:**

<http://www.sciencekids.co.nz/>

<http://www.csun.edu/science/physics/>

<http://www.physicslessons.com/demos.html>

<http://school.familyeducation.com/astronomy/solar-system/70021.html>

[http://www.primaryscience.ie/activities\\_planet\\_profiles.php](http://www.primaryscience.ie/activities_planet_profiles.php)